



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep. 03-03/DPK	Nr. Prot. 01-2460/16	Br. Prot. 01-2460/16	Prot No. 01-2460/16
Broj stranica 04	Data 01-08-2016	Datum 01-08-2016	Prishtine

DATE/A:	01.08.2016
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP 03-03/2355/16
PËR/ZA/TO:	z. Besim TAHIRI, Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit në Ministrinë e Infrastrukturës
CC:	z. Xhelil BEKTESHI, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Rehabilitimi i Rrugës: Lipjan-Magurë L-9280 m "

I nderuari z. Tahiri ,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " Rehabilitimi i Rrugës Lipjan-Magurë L-9280m " me numër prokurimi: MI-16-084-511, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin "**Rehabilitimi i Rrugës Lipjan-Magurë L-9280m " me numër prokurimi: MI-16-084-511**, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsy etimi

Agjencia kundër Korrupsionit me datë 20.07.2016, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-2355/16* për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "*Rehabilitimi i Rrugës Lipjan-Magurë L-9280m*" me numër prokurimi: *MI-16-084-511*, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Ministria e Infrastrukturës.

Agjencia kundër Korrupsionit me datë 20.07.2016, ka paraqitur kërkesë për dokumentacion, ku ka kërkuar nga Autoriteti në fjalë që ta dorëzoj në Agjenci dokumentacionin përkatës për këtë procedurë të prokurimit para hapjes së tenderit. Autoriteti kontraktues me datë 25.07.2016 ka ofruar tërë dokumentacionin e kërkuar nga Agjencia.

Agjencia kundër Korrupsionit duke vepruar sipas detyrës zyrtare ka trajtuar këtë procedurë të prokurimit dhe pas shqyrtimit të dokumenteve të dosjes së këtij tenderi, ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim: Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me datë 23.06.2016, ku për këtë aktivitet të prokurimit Autoriteti kontraktues ka paraparë procedurën e hapur, kontratë të llojit punë ndërtimore me vlerë të madhe të kontratës.

Pas analizimit të njoftimit për kontratë, Agjencia ka vërejtur se tek rubrika III.2.4. e kapacitetit teknik/profesional, pika 8 është kërkuar që Operatorët ekonomik *duhet të dëshmojnë se mesatarja e të punësuarve në tri vitet e fundit (2013,2014,2015) duhet të jetë mesatarisht 100 të punësuar, ndërsa si dëshmi dokumentare ka kërkuar listën e pagave të Operatorit ekonomik të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës*, kërkesë kjo për të cilën konsiderojmë se bie ndesh me nenin 69 të Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik. Sipas dispozitave të Ligjit në fuqi për prokurimin publik dhe Udhëzuesit Operativ për prokurimin publik, Autoriteti kontraktues mund të kërkojë minimumin e mesatares së fuqisë punëtore dhe stafit menaxherial për secilin nga 3 vitet e fundit, ku si dëshmi mund të kërkojë një deklaratë apo raport për fuqinë mesatare punëtore dhe numrin mesatar të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik për secilin nga tri vitet e kaluara.

Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se një kërkesë e tillë e vendosur nga Autoriteti kontraktues është diskriminuese dhe nuk u mundëson Operatorëve tjerë të cilët kanë një numër minimal të fuqisë punëtore të ofertojnë për këtë kontratë. Duke caktuar një kufizim të tillë Autoriteti kontraktues favorizon vetëm Operatorët ekonomik të cilët kanë këtë numër të të punësuarve ose më tepër dhe në këtë mënyrë i eliminon operatorët tjerë të cilët kanë një numër të kënaqshëm të të punësuarve. Duke caktuar një kërkesë të tillë Autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 7 të Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik, ku sipas këtij ligji thuhet se "*Autoriteti Kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik*".

Gjatë analizimit të dosjes së këtij tenderi dhe krahasimit me njoftimin për kontratë e cila është përgatitur nga ana e Autoritetit kontraktues, Agjencia ka vërejtur se këto dy dokumente nuk janë identike njëra me tjetrën më saktësisht në lidhje me pikën 8, të rubrikës kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale të njoftimit për kontratë është kërkuar që Operatorët ekonomik **duhet të dëshmojnë se mesatarja e të punësuarve në tri vitet e fundit (2013,2014,2015) duhet të jetë mesatarisht 100 të punësuar**, ndërsa në dosjen e tenderit nuk ekziston fare një kërkesë e tillë. Duke vepruar në këtë mënyrë Autoriteti kontraktues krijon pa barazi dhe diskriminim në mesin e Operatorëve ekonomik.

Sipas nenit 13 paragrafi 2 i cili është plotësim i nenit 27 të Ligjit bazik nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/1-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/1-237, theksohet decidivisht se **Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike.**

Agjencia gjithashtu ka vërejtur se në rubrikën III.2.4. tek kapaciteti teknik/profesional pika 6 Autoriteti kontraktues ka kërkuar nga Operatorët ekonomik të kenë minimum dy (2) projekte të realizuara në lëmin e ndërtimit të rrugëve nacionale ose regjionale në vlerë jo më pak se 900,000.00 euro.

Në lidhje me kërkesën si më lartë Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se kjo kërkesë gjithashtu bie ndesh me nenin 69 të Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik.

Sipas këtij Ligji për ta vërtetuar aftësinë teknike ose profesionale, Autoriteti kontraktues mund të kërkojë vlera minimale referenca në lidhje me punët ndërtimore në 3 vitet e fundit përmes një liste që specifikon secilin nga projektet punuese të Operatorëve ekonomik dhe aktiviteteve të ndërtimit të kryera nga OE në 3 vitet e fundit të përcjellë me certifikatë të ekzekutimit të mirë që tregojnë vlerën, datën dhe llojin dhe vendin e projektit punues dhe/ose aktiviteteve të ndërtimit.

Por nuk është e lejuar që Autoriteti kontraktues të caktojë numrin e referencave të cilat duhet të korrespondojnë me vlerën e caktuar të caktuar si më lartë. Nëse Autoriteti kontraktues ka për synim që ta vërtetojë qarkullimin minimal financiar të realizuar përmes kontratave, atëherë duhet që të kërkojë vlerën e përgjithshme monetare të punëve të realizuara në tri vitet e fundit e jo të kërkohet numër i caktuar i referencave në vlerën e caktuar si më lartë.

Konsiderojmë se kërkesat e tilla si në rastin konkret e kufizojnë konkurrencën e lirë dhe diskriminojnë Operatorët ekonomik të cilët kanë një kapacitet të kënaqshëm të ekonomik e teknik-profesional.

Veprimet e Autoritetit kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi, nenin 27 Dosja e tenderit, nenin 13 dhe nenin 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale i Ligjit Nr. 05/L -068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/1-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/1-237 dhe me nenin 26 e Udhëzuesit Operativ të Prokurimit publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet të lejohen dhe të përsëriten në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

